



Në mbështetje të nenit 41, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18, si dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21) dhe nenit 106, paragrafi 4 dhe nenit 121 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19, si dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/18 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

VENDIM

për përmbajtjen e auditimit të pasqyrave financiare vjetore dhe të punës së bankës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 83/22)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet përmbajtja e auditimit të pasqyrave financiare vjetore dhe të punës së bankës, që e bën shoqëria e auditimit.

2. Për nevojat e këtij vendimi, me "auditim i bankës" nënkuptohet:

- auditimi i pasqyrave financiare vjetore të përpiluara nga banka në bazë të rregulloreve të kontabilitetit në fuqi, dhe
- auditimi i punës së bankës.

Auditimi sipas paragrafit 1 të kësaj pike, bëhet në përputhje me Ligjin e Auditimit, këtë vendim dhe rregulloret e standardet e tjera të auditimit.

3. Për çdo gjë që nuk është përcaktuar me këtë vendim, zbatohet në mënyrë të duhur kuptimi i termave të përcaktuara me Ligjin e Bankave dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

II. PËRMBAJTJA DHE AUDITIMI I BANKËS

4. Pas auditimit të bankës, shoqëria e auditimit duhet të përpilojë raportin për pasqyrat financiare të bankës, përkatësisht të japë mendimin, po qe se pasqyrat financiare vjetore të bankës janë përpiluar në përputhje me rregulloret e kontabilitetit në zbatim, nëse raportet japin një pasqyrë të vërtetë dhe objektive ose nëse i paraqesin në mënyrë objektive, nga të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të bankës në datën e pasqyrave financiare dhe rezultatet e punës dhe flukseve monetare për vitin që përfundon në datën e pasqyrave financiare.

5. Mendimit të pikës 4 të këtij vendimi, shoqëria e auditimit duhet t'i bashkëngjisë pasqyrat financiare të bankës që janë objekt i auditimit (bilancin e suksesit, raportin e fitimit gjithëpërfshirës, bilancin e gjendjes, raportin e ndryshimeve në kapital dhe në rezerva, raporti e fluksit të parasë dhe vërejtjet ndaj pasqyrave financiare), të përpiluara në përputhje me rregulloren e kontabilitetit në zbatim.

6. Raportit të pikës 4 të këtij vendimi dhe pasqyrave financiare të pikës 5 të këtij vendimi, shoqëria e auditimit duhet t'i bashkëngjisë edhe:

6.1. Letrën e shoqërisë së auditimit drejtuar këshillit drejtues të bankës.

6.2. Analizën e korrigjimeve në pasqyrat financiare të bankës, të propozuara nga shoqëria e auditimit, veçmas: korrigjimet që banka i pranoi dhe të cilat ishin përfshirë në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare; korrigjimet që banka nuk i pranoi dhe analizën e kërkesave të paplotësuara për deklaram në pasqyrat financiare.

6.3. Analizën e: nivelit të materialitetit të pasqyrave financiare në tërësi, nivelet e materialitetit të klasave të caktuara transaksionesh, bilancet e llogarive dhe deklaramet (nëse ka) dhe materialiteti i kryerjes së auditimit, të cilat audituesi i ka përcaktuar dhe zbatuar gjatë auditimit të bankës.

6.4. Raportet që banka ia dorëzon Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore), për qëllimet e mbikëqyrjes me gjendjen në datën e pasqyrave financiare, të cilat i referohen mjaftueshmërisë së kapitalit, pozicionit të hapur të këmbimit valutor, rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të ndryshimit të normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare dhe rreziqet e tjera për të cilat janë përcaktuar raporte përkatëse nga Banka Popullore. Këto raporte përpilohen nga banka dhe duhet të harmonizohen me pasqyrat financiare të pikës 5 të këtij vendimi. Nëse bëhen korrigjime në pasqyrat financiare vjetore, dallimet e përcaktuara paraqiten veçmas.

6.5. Shtojca, e cila përmban të paktën:

6.5.1. Përshkrimin e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm për të mbuluar rreziqet dhe përshkrimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm në përputhje me profilin e rrezikut të bankës dhe/ose mjedisit të saj. Përshkrimi i procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve përmban gjithashtu të dhëna dhe informacione për shumën e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit në datën e pasqyrave financiare, shumën e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit të kërkuar dhe aktivitetet e parashikuara nga banka për të arritur dhe ruajtur nivelin e kërkuar të mjeteve vetjake dhe shkallën e nevojshme të mjaftueshmërisë së kapitalit (plani i kapitalit), si dhe rekomandimet e mundshme të shoqërisë së auditimit në lidhje me menaxhimin e kapitalit të bankës. Përshkrimi i procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm përmban të dhëna dhe informacione për likuiditetin e brendshëm të përcaktuar dhe likuiditetin aktual dhe krahasimin e tyre, një plan me aktivitetet e parashikuara nga banka për të arritur dhe/ose ruajtur likuiditetin e brendshëm të nevojshëm në përputhje me nevojat e përcaktuara aktuale dhe të ardhshme për mjetet likuide dhe burimet e mjeteve, si dhe rekomandimet e mundshme të shoqërisë së auditimit në lidhje me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit nga banka;

6.5.2. Përshkrimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut të bankës, përkatësisht përshkrimin e procesit të menaxhimit të rrezikut i cili bazohet në nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut (dokument për nivelin e pranueshëm të rrezikut, politikat dhe aktet e tjera të brendshme për identifikimin, matjen ose vlerësimin, kontrollin ose reduktimin dhe monitorimin e rreziqeve individuale, rregullat e testimit të stresit, rregullat e futjes së një produkti, aktiviteti ose sistemi të ri në bankë, rregullat e përdorimit të shërbimeve nga të huajt, sistemin e informacionit), si dhe struktura organizative e menaxhimit të rrezikut, me rekomandime të mundshme të shoqërisë së auditimit në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të veçanta. Në të njëjtën kohë, duhet të mbulohen së paku rreziqet që mbulohen me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut, si dhe të gjitha rreziqet e tjera materiale ndaj të cilave banka është e ekspozuar në operacionet e saj;

6.5.3. Përshkrimin e: metodologjisë së bankës për klasifikimin e ekspozimeve të kredisë dhe përcaktimin e humbjes së pritshme të kreditorë në baza individuale dhe grupe, pra për zhvlerësimin / rezervën speciale; dallimeve të mundshme në nivelin e zhvlerësimit të përcaktuar / rezervës speciale në datën e pasqyrave financiare ndërmjet shoqërisë së auditimit dhe bankës (në bazë individuale dhe grupe); kriterëve për krijimin e portofolit kreditor; ristrukturimet dhe shlyerjet e rëndësishme të zbatuara të ekspozimeve kreditorë; metodologjinë e bankës për vlerësimin e aktiveve të supozuara në bazë të kërkesave të papaguara dhe dallimeve të mundshme në nivelin e humbjes së konstatuar nga zhvlerësimi; vlerësimin e zërave më të rëndësishëm të portofolit të tregtimit; si dhe çështjeve gjyqësore më të rëndësishme;

6.5.4. Përshkrimin e përputhshmërisë së operacioneve të bankës me rregulloret me gjendjen në datën në të cilën referohet raporti për pasqyrat financiare të bankës nga auditimi i kryer. Nëse shoqëria e auditimit zbulon parregullsi dhe mospërputhje të rëndësishme me rregulloret dhe aktet e brendshme të bankës gjatë periudhës që është lëndë e auditimit, duhet t'i deklarojë në këtë pjesë të shtojcës, duke përfshirë masat e mundshme që banka ka ndërmarrë për të kapërcyer mospërputhjet;

6.5.5. Përshkrimin e saktësisë dhe plotësisë së raporteve të pikës 6, nën-pikës 6.4 të këtij vendimi, të cilat banka ia dorëzon Bankës Popullore, për qëllimet e mbikëqyrjes;

6.5.6. Përshkrimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe performancëm e funksionit të auditimit të brendshëm në përputhje me rregulloret, si dhe rekomandimet e mundshme për përmirësim;

6.5.7. Përshkrimin e sigurtë së sistemit të informacionit në aspekt të harmonizimit të tij me funksionimin dhe objektivat e bankës, mbrojtjen e të dhënave dhe sistemet e vendosura të kontrollit, si dhe rekomandimet e mundshme për përmirësim. Shoqëria e auditimit duhet të japë një koment nëse banka ka miratuar dhe zbatuar politika dhe akte të brendshme për sigurinë e sistemit të informacionit;

6.5.8. Përshkrimin e saktësisë dhe plotësisë së të dhënave që banka është e detyruar t'i publikojë në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për publikimin e raporteve dhe të dhënave nga banka;

6.5.9. Përshkrimin e sistemit të bankës kundër pastrimit të parave;

6.5.10. Përshkrimin e ndryshimeve të rëndësishme në strukturën ligjore dhe organizative të bankës, ndryshimeve të rëndësishme në fushën dhe strukturën e veprimtarive financiare të bankës, si dhe përshkrimin i rasteve dhe të arsyeve të largimit të papritur nga banka të një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta;

6.5.11. Pyetësorët, të cilët janë dhënë në formularin që është Shtojca 1 e këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, të plotësuara dhe të nënshkruara nga shoqëria e auditimit.

7. Auditimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i operacioneve të grupit bankar duhet të përfshijë gjithashtu:

7.1. Përshkrimin e metodës së zbatuar të konsolidimit. Nëse subjekti amë i grupit bankar ka ndryshuar metodën e konsolidimit në vitin për të cilin pasqyrat financiare dhe operacionet janë lëndë e auditimit, auditori duhet të nënvizojë ndryshimin, të deklarojë arsyet për të cilat është bërë dhe të tregojë efektet e atij ndryshimi në pasqyrat financiare të konsoliduar;

7.2. Efektet e konsolidimit;

7.3. Përshkrimin e përbërjes së grupit bankar, duke treguar për secilin anëtar të grupit: emrin, selinë, veprimtarinë kryesore, shumën e aktives dhe të kapitalit, pjesëmarrjen e shoqërisë amë në numrin total të aksioneve dhe në aksionet me të drejtë vote të çdo anëtar të grupit bankar;

7.4. Emrin e shoqërisë/shoqërive të auditimit që audituan anëtarët e grupit bankar, si dhe mendimin i auditorit për pasqyrat e tyre financiare;

7.5. Listën e institucioneve të tjera financiare dhe shoqërive për shërbime bankare ndihmëse që janë subjekte të varura në grupin bankar, por që janë të përjashtuara nga konsolidimi për qëllime mbikëqyrëse, duke treguar arsyet për të cilat janë përjashtuar nga konsolidimi;

7.6. Përshkrimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të grupit bankar, nëpërmjet përshkrimit të politikave të miratuara të menaxhimit të rrezikut dhe akteve të brendshme për identifikimin, matjen ose vlerësimin, kontrollin ose zvogëlimin dhe monitorimin e rreziqeve individuale, me rekomandimet e mundshme të shoqërisë së auditimit në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të veçanta.

III. BASHKËPUNIM DHE RAPORTIM

8. Shoqëria e auditimit detyrohet të paraqesë raportin mendimin e pikës 4 të këtij vendimi, pasqyrat financiare të pikës 5 të këtij vendimi dhe elementet e pikës 6 të këtij vendimi, në përputhje me përcaktimet e Ligjit të Bankave.

9. Nëse banka ka pranuar korrigjimet në pasqyrat financiare vjetore të pikës 6, nën pikës 6.2 të këtij vendimi, ajo duhet të bëjë ndryshimet përkatëse në librat e saj të biznesit jo më vonë se afati në të cilin dorëzohet raporti mujor për gjendjen dhe qarkullimin e të gjitha llogarive për 30 qershorin e vitit aktual.

10. Banka është e detyruar që brenda 15 ditëve pas miratimit të raportit nga

kuvendi, të publikojë raportin e auditimit të kryer të pasqyrave financiare vjetore, si më poshtë vijon:

- të publikojë në faqen e saj të internetit: raportin (mendimin) e shoqërisë së auditimit nga pika 4 e këtij vendimi dhe pasqyrat financiare nga pika 5 e këtij vendimi. Ato qëndrojnë në faqen e bankës të paktën deri në publikimin e raportit të vitit të ardhshëm;
- të publikojë në të paktën në një gazetë ditore: raportin (mendimin) e shoqërisë së auditimit nga pika 4 e këtij vendimi dhe pasqyrat financiare nga pika 5 e këtij vendimi, pa vërejtjet e pasqyrave financiare.

Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar të publikojë raportin e auditimit në mënyrë të konsoliduar, në mënyrën e përcaktuar sipas paragrafit 1 të kësaj pike, brenda 15 ditëve nga miratimi i raportit nga kuvendi i subjektit amë të grupit bankar.

11. Banka detyrohet që një kopje të publikimit në gazetën ditore, të pikës 10, paragrafi 1, nënparagrafi 2 të këtij vendimi, t'ia dorëzojë Bankës Popullore brenda 5 ditëve nga data e publikimit.

IV. DISPOZITA KALIMARE DHE PËRFUNDIMTARE

12. Dispozitat e këtij vendimi që u referohen bankave zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe për filialet e bankave të huaja dhe kursimoret..

13. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 korriku 2022.

14. Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, përfundon së vlefshmi Vendimi për përmbajtjen e pasqyrave financiare të bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 116/14).

O nr. 02-15/V-2/2022
31 mars 2022
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

PYETËSORË

	Kapitali, mjetet vetjake dhe mjaftueshmëria e kapitalit	PO	JO	Koment¹
1	A ka vendosur banka një proces të përcaktimit të kapitalit të brendshëm për të mbuluar rreziqet ndaj të cilave është ose mund të ekspozohet gjatë operacioneve të saj?			
2	A i përfshin procesi i përcaktimit të kapitalit të brendshëm të gjitha rreziqet materiale ndaj të cilave banka është ose mund të ekspozohet gjatë operacioneve të saj?			
3	A ka vendosur banka një proces të përcaktimit të kapitalit të brendshëm në baza individuale dhe të konsoliduara (nëse banka është një person amë), banka mund të ekspozohet gjatë operacioneve të saj?			
4	A bën banka testimin e stresit për të përcaktuar ndikimin e goditjeve në mjaftueshmërinë e kapitalit?			
5	A i merr banka parasysh rezultatet e testimit të stresit të bërë gjatë përcaktimit të kapitalit të brendshëm për të mbuluar rreziqet individuale dhe të totalit të kapitalit të brendshëm?			
6	A ka përpiluar banka një plan kapital për të arritur dhe ruajtur nivelin e nevojshëm të mjeteve vetjake, përkatësisht mjaftueshmërisë së nevojshme të kapitalit (nëse është dashur të përgatisë një plan të tillë në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut)?			
7	A e auditon banka procesin e brendshëm të përcaktimit të kapitalit, duke përfshirë të gjitha aktet e brendshme që dokumentojnë zbatimin e tij?			
8	A ka auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme për vlerësimin e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm, arritjes dhe ruajtjes së nivelit të mjeteve dhe të mjaftueshmërisë së nevojshme të kapitalit të bankës, si dhe saktësisë dhe besueshmërisë së raportit për procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut?			
9	A është llogaritja e mjaftueshmërisë së kapitalit në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Banka Popullore?			
10	A i plotëson banka kërkesat për shtresat mbrojtëse të kapitalit?			
11	A e llogarit banka shumën maksimale të shpërndarjes së rezultatit të operacionit dhe a përputhet llogaritja me metodologjinë e përcaktuar nga Banka Popullore?			
12	A i kryen banka aktivitetet e parashikuara në planin e ruajtjes së kapitalit (nëse ka një plan të tillë)?			

¹ Në kolonën "koment", shoqëria e auditimit mund të japë një shpjegim më të hollësishëm për çështjet më individuale.

13	A e miraton këshilli mbikëqyrës blerjen e aksioneve të kapitalit dhe blerjen e letrave me vlerë që kalojnë 5% të mjeteve vetjake të bankës?			
14	A e kalon pasuria e bankës në tokë, ndërtesa, pajisje dhe pjesë kapitale në institucionet jofinanciare, 60% të mjeteve vetjake të bankës?			
15	A e tejkalon shuma agregate e aksioneve të kapitalit të bankës në institucionet jofinanciare 30% të mjeteve vetjake të bankës?			
16	A e kalon pjesa individuale e kapitalit të bankës në institucion jofinanciar 15% të mjeteve të bankës?			
17	A realizon banka kontroll në institucion jofinanciar, me përjashtim të shoqërive për shërbime bankare ndihmëse?			
18	A zotëron banka më shumë se 5% të aksioneve të bankës tjetër ose të institucionit financiar jobankar që zotëron më shumë se 5% të totalit të aksioneve të bankës?			
19	A ka shitur aksionari me pjesëmarrje të kualifikuar në bankë një pjesë të aksioneve të tij, duke e ulur kështu pjesëmarrjen e tij nën pragun për të cilin ka marrë pëlqimin nga Banka Popullore, pa e njoftuar Bankën Popullore?			
20	A e ka njoftuar banka Bankën Popullore për ndryshimet në strukturën e pronësisë ose për emetim të ri të aksioneve?			
21	A ka marrëveshje me të cilën aksionarët e bankës bashkojnë të drejtat e votës nga aksionet në bankë?			
22	A janë transaksionet me aksionet vetjake të kryera në përputhje me rregulloret?			
23	A ka auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme auditimit në fushën e mjeteve vetjake të bankës dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit?			
24	A është frekuenca e auditimeve të brendshme në këtë fushë në përputhje me vëllimin e aktiviteteve dhe ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve??			
25	A ndiqen rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm??			
26	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi²: _____

Nënshkrimi _____

² Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit që kanë plotësuar pyetësorin.

	Rreziku kreditor	PO	JO	Koment
1	A ka banka politikë dhe akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut kreditor?			
2	A e ka miratuar autoriteti kompetent përkatës politikën dhe aktet e brendshme për menaxhimin e rrezikut kreditor?			
3	A përmban politika e menaxhimit të rrezikut kreditor rregulla të përgjithshme për strukturën organizative të menaxhimit të rrezikut kreditor; a bazohet në dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut; a është në përputhje me planin e zhvillimit dhe të politikën e biznesit të bankës?			
4	A i përfshin politika dhe aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut kreditor fazat e identifikimit, matjes, kontrollit ose zvogëlimit dhe monitorimit të rrezikut kreditor?			
5	A rishikohen rregullisht politika e menaxhimit të rrezikut kreditor dhe aktet e brendshme të bankës??			
6	A ka krijuar banka një strukturë organizative me kompetenca të përcaktuara saktë dhe linja përgjegjësie, bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni gjatë menaxhimit të rrezikut kreditor?			
7	Punonjësit e bankës, të përfshirë në procesin e miratimit dhe monitorimit të kredisë, si dhe në menaxhimin e kreditor, a janë të njohur me përmbajtjen e politikës kreditore dhe aktet e brendshme dhe a i respektojnë?			
8	A janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e personave dhe njësive organizative përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe punën e mëparshme në lidhje me kreditimin, si dhe të personave dhe njësive organizative bartëse të aktivitetit kreditor dhe që janë përgjegjës për marrjen e rrezikut kreditor?			
9	A ka krijuar banka një sistem për menaxhimin e rrezikut të përqendrimit të ekspozimit, rrezikut të vendit dhe rrezikut të palës tjetër kontraktuese?			
10	A jep banka një përlllogaritje të vlerës së tregut të kolateralit të ekspozimit kreditor në përputhje me rregulloren?			
11	A ka kontroll dhe monitorim të përdorimit të kredive të miratuara në përputhje me qëllimin e tyre në bazë të marrëveshjeve të lidhura?			
12	A ka banka sistem raportimi që duhet të sigurojë raporte për të paktën: – strukturën e ekspozimit të përgjithshëm kreditor, – ekspozimin e përgjithshëm kreditor ndaj personave të lidhur, – ekspozimet kreditore me probleme, – lëvizjen (migrimin) e ekspozimeve kreditore ng njëra kategori rreziku në tjetrën në një periudhë të caktuar kohore,			

	– ekspozimet kreditore të miratuara në përputhje me përjashtimet e lejueshme, – rezultatet e testimit të stresit, – ekspozimet kreditore të ristrukturuara, – ekspozimet kreditore të fshira dhe ekspozimet kreditore të bartura nga evidenca jashtë bilancit, – nivelin dhe lëvizjet e humbjes së pritshme kreditore, përkatësisht zhvlerësimin dhe rezervën e posaçme, – ekspozimet kreditore të shlyera me probleme, të fshira dhe ekspozimet kreditore të cilat janë bartur në evidencën jashtë bilancit, – kërkesat e shitura?			
13	A ofron sistemi raportimin në kohë dhe të saktë te autoritetet drejtuese dhe mbikëqyrëse, në lidhje me ekspozimin e bankës ndaj rrezikut kreditor?			
14	A ka banka një person/njësi organizative të veçantë për menaxhimin e ekspozimeve kreditore me probleme?			
15	A kalon ekspozimi ndaj një personi dhe personave të lidhur me atë person 25% të mjeteve vetjake bankës?			
16	A kalon ekspozimi ndaj filialit të bankës 10% të mjeteve vetjake të bankës?			
17	A tejkalon ekspozimi ndaj aksionarit me pjesëmarrje të kualifikuar në bankë dhe personave të lidhur me të 10% të mjeteve vetjake të bankës?			
18	A kalon ekspozimi ndaj një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të lidhur me të 3% të mjeteve vetjake të bankës?			
19	A e kalon ekspozimi total ndaj personave nga pyetjet numër 16, 17 dhe 18, 65% të mjeteve vetjake të bankës?			
20	A i identifikon banka në mënyrë përshtatshme zërat e zbritshëm nga ekspozimi gjatë përcaktimit të kufijve të ekspozimit nga pyetjet numër 16, 17 dhe 18?			
21	A janë miratuar kreditë dhe format e tjera të ekspozimit ndaj personave nga pyetjet numër 16, 17 dhe 18 në vlerë prej mbi gjashtë milionë denarë, në përputhje me vendimin e këshillit mbikëqyrës të bankës?			
22	A janë në të njëjtin nivel të rrezikut kushtet në të cilat miratohen kreditë dhe të gjitha format e tjera të ekspozimit të personave nga pyetjet numër 16, 17 dhe 18 më të favorshme se kushtet e zbatuara për klientët e tjerë të bankës?			
23	A e tejkalon shuma totale e ekspozimeve të mëdha (mbi 10% e mjeteve vetjake) tetëfishin e shumës së mjeteve vetjake të bankës?			
24	A ka miratuar banka një kredi apo ka krijuar një formë tjetër ekspozimi që është përdorur për të blerë aksione në të njëjtën bankë?			

25	A ka miratuar banka një kredi apo ka krijuar një formë tjetër ekspozimi me një peng aksionesh të emetuara nga e njëjta bankë?			
26	Gjatë klasifikimit të ekspozimit kreditor, a merr banka parasysh aftësinë kreditore të klientit, përkatësisht cilësinë e projektit dhe ndryshimet që ndodhin në aftësinë kreditore të klientit, pra cilësinë e projektit, si dhe rregullsinë gjatë shlyerjes së detyrimeve?			
27	A ka krijuar banka një sistem të përshtatshëm për përcaktimin, monitorimin, raportimin dhe regjistrimin e palëve të lidhura, ekspozimeve të mëdha dhe kufijve të ekspozimit, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për mënyrën e përcaktimit të palëve të lidhura dhe kufijve të ekspozimit?			
28	A merr banka, gjatë përcaktimit të aftësisë kreditore të klientit, ndikimet e mundshme nga personat e lidhur me klientin?			
29	A e vlerëson banka aftësinë kreditore të klientit në momentin e miratimit të ekspozimit kreditor dhe kur ndryshon kushtet kontraktuale (për të gjithë klientët – persona fizikë dhe juridikë), si dhe të paktën një herë në gjashtë muaj ose më shpesh se gjashtë muaj, nëse kriteret për një rritje të rrezikut kreditor plotësohen (vetëm për një klient person juridik)?			
30	A e dokumenton banka metodën e përcaktimit të vlerës së kolateralit, përkatësisht a e përfshin banka si duhet vlerën e kolateralit në llogaritjen e vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme në të ardhmen?			
31	A e dokumenton banka datën e pritshme të shlyerjes së ekspozimit kreditor me kolateralin gjatë llogaritjes së vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme në të ardhmen?			
32	A ka banka në aktet e saj të brendshme kriteret për përcaktimin, identifikimin dhe monitorimin e ekspozimeve kreditore me probleme dhe për ndërmarrjen e aktiviteteve për mbledhjen dhe/ose shitjen e tyre??			
33	A ka përcaktuar banka pragje për ekspozimin ndaj rrezikut kreditor, pragje për paralajmërimin e hershëm dhe kufij të brendshëm për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut kreditor dhe a i zbaton dhe monitoron?			
34	A ka përcaktuar banka në aktet e saj të brendshme përjashtime të lejuara dhe rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
35	A përcakton dhe zbaton banka kriteret të veçanta me rastin e miratimit të kredive në valutë dhe në denarë me klauzolë valutore??			
36	A ka banka kufizime sasiore për pjesëmarrjen e ekspozimit kreditor në valutë të huaj dhe në denarë me klauzolë valutore në totalin e ekspozimit kreditor të bankës?			

37	A ka banka kufizime sasiore për treguesin DTI dhe treguesin LTV gjatë miratimit dhe monitorimit të kredive në valutë dhe në denarë me klauzolë valutore?			
38	A mban banka dosje krediti për çdo klient/projekt që përmban informacione për identitetin, aftësinë kreditore të klientit, cilësinë e projektit, rregullsinë në shlyerjen e detyrimeve dhe cilësinë e kolateralit??			
39	A ka miratuar auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme për auditimin e performancës së funksionit kreditor dhe menaxhimin e rrezikut kreditor?			
40	A është frekuenca e auditimeve të brendshme të lidhura me rrezikun kreditor, në përputhje me vëllimin e kreditimit dhe ekspozimin e bankës ndaj këtij rreziku, si dhe me sistemin e vendosur të menaxhimit të këtij rreziku?			
41	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm?			
42	Kur prezanton një produkt ose shërbim të ri, a kryen banka një analizë të dokumentuar për të vlerësuar ndikimin e tyre në ekspozimin ndaj rrezikut kreditor dhe në procesin e menaxhimit të këtij rreziku?			
43	A bën banka testimin e stresit të ekspozimit ndaj kreditor?			
44	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi³: _____

Nënshkrimi _____

³ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Rreziku nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare	PO	JO	Koment
1	A ka banka politika dhe akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
2	A janë miratuar politika dhe aktet e brendshme për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare nga autoriteti përkatës kompetent?			
3	A përmban politika e bankës për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, rregulla të përgjithshme për strukturën organizative të menaxhimit të rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare; a bazohet në dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut, përkatësisht a është në përputhje me planin zhvillimor të bankës dhe politikën e biznesit?			
4	A i përfshin politika dhe aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare fazat e identifikimit, matjes, kontrollit ose zvogëlimit dhe monitorimit të rrezikut kreditor?			
5	A rishikohen rregullisht politika e bankës për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare dhe aktet e tjera të brendshme përkatëse në varësi të kushteve të tregut dhe të vëllimit të aktiviteteve të bankës?			
6	Punonjësit e bankës, të cilët janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, a janë të njohur me përmbajtjen e politikës dhe akteve të brendshme për menaxhimin e këtij rreziku dhe a i respektojnë?			
7	A ka përcaktuar banka pragje për ekspozimin ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, pragje për paralajmërimin e hershëm dhe pragje të brendshme për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare dhe a zbatohen dhe monitorohen?			
8	A ka përcaktuar banka në aktet e saj të brendshme përjashtime të lejuara dhe rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
9	A përdor banka instrumente financiare për mbrojtje kundër rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare (derivate)?			
10	A lidh banka kontrata të reja në të cilat norma e interesit ndryshon në bazë të vendimit të një organi përkatës të bankës (normë e rregullueshme e interesit)?			
11	Në kuadër të strukturës organizative të bankës, a veçohen aktivitetet për t'u mbrojtur kundër rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare nga aktivitetet që lidhen me portofolin e tregtimit?			

12	Kur prezanton një produkt ose shërbim të ri, a kryen banka një analizë të dokumentuar për të vlerësuar ndikimin e tyre në ekspozimin ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare dhe në procesin e menaxhimit të këtij rreziku?			
13	A ka auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme për auditimin e menaxhimit të rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
14	A është frekuenca e auditimeve të brendshme që ka të bëjë me rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare në përputhje me ekspozimin e bankës ndaj këtij rreziku dhe me sistemin e vendosur të administrimit të këtij rreziku?			
15	A përfshin auditimi i brendshëm gjithashtu një vlerësim të procedurave dhe teknikave të përdorura nga banka për të matur rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
16	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm?			
17	A i përfshin auditimi i brendshëm masat që ndërmerr banka nëse ndryshimi i vlerës ekonomike të portofolit të aktiviteteve bankare, si rezultat i ekspozimit ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit, është i barabartë ose më i madh se 20% në raport me mjetet vetjake?			
18	A ka banka sistem informacioni për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, që është në përputhje me vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të bankës?			
19	A ofron sistemi raportim në kohë dhe të saktë tek organet drejtuese, në lidhje me ekspozimin e bankës ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
20	A e bën banka testin e stresit të ekspozimit ndaj rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare?			
21	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi⁴: _____

Nënshkroi _____

⁴ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësorin.

	Rreziku i likuiditetit	PO	JO	Koment
1	A ka banka politika dhe akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit ?			
2	A janë miratuar politika dhe aktet e brendshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit nga autoriteti përkatës kompetent?			
3	A përmban politika e bankës për administrimin e rrezikut të likuiditetit, rregulla të përgjithshme për strukturën organizative të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit; a bazohet në dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut, përkatësisht a është harmonizuar me planin zhvillimor të bankës dhe politikën e biznesit?			
4	A i përfshin politika dhe aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, fazat e identifikimit, matjes, kontrollit ose zvogëlimit dhe monitorimit të rrezikut kreditor?			
5	A rishikohen rregullisht politika e bankës dhe aktet e tjera të brendshme, për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit			
6	Punonjësit e bankës, të cilët janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, a janë të njohur me përmbajtjen e politikës dhe akteve të brendshme për menaxhimin e këtij rreziku dhe a i respektojnë?			
7	A është llogaritja e shkallës së mbulimit të likuiditetit në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Banka Popullore?			
8	A ka përcaktuar banka në aktet e saj të brendshme prag për shumën e shkallës së mbulimit të likuiditetit, prag paralajmërimi të hershëm dhe prag të brendshëm për shumën e shkallës së mbulimit të likuiditetit dhe a i zbaton dhe monitoron?			
9	A ka përcaktuar banka brenda akteve të saj të brendshme tregues të brendshëm të likuiditetit?			
10	A ka përcaktuar banka në aktet e saj të brendshme përjashtime të lejuara procedurë për miratimin e tyre?			
11	A ka përcaktuar banka brenda akteve të saj të brendshme pragje për treguesit e brendshëm të likuiditetit, pragje për paralajmërimin e hershëm dhe pragje të brendshëm për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit dhe a i zbaton dhe monitoron?			
12	A bën banka, për qëllime të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, monitorimin e likuiditetit sipas çdo valute të rëndësishme?			
13	A ka vendosur banka një proces për përcaktimin e likuiditetit të brendshëm??			
14	A përfshin procesi i përcaktimit të likuiditetit të brendshëm të gjitha rreziqet materiale të likuiditetit ndaj të cilave banka është ose mund të ekspozohet gjatë operacioneve të saj?			
15	A zhvillon banka plan me aktivitete për arritjen dhe/ose ruajtjen e likuiditetit të brendshëm të nevojshëm			

	të përcaktuara për mjetet likuide dhe burimet e mjeteve?			
16	A e auditon banka procesin e brendshëm të përcaktimit të likuiditetit, duke përfshirë të gjitha aktet e brendshme që dokumentojnë zbatimin e tij?			
17	A ka banka në dispozicion linja të hapura krediti të pakthyeshme ose burime të tjera likuiditeti, të cilat mund t'i përdorë shpejt dhe pa kushte në rast të mungesës së likuiditetit?			
18	A monitoron banka çmimin e burimeve të mjeteve dhe maturimin e tyre dhe a përdor burimet e mjeteve me kushte më pak të favorshme se ato të tregut?			
19	A e monitoron banka nivelin e depozitave të vogla të qëndrueshme?			
20	A e monitoron banka përqendrimin e burimeve të mjeteve nga depozituesit dhe sipas llojeve të instrumenteve, përkatësisht produkteve?			
21	A monitoron banka mundësinë e rinovimit të burimeve të mjeteve?			
22	A përcakton dhe monitoron banka mjetet në dispozicion, të pangarkuara, që mund të përdoren si kolateral për të marrë burime shtesë mjeteve?			
23	A e ka përcaktuar banka mënyrën e përdorimit të mjeteve të Bankës Popullore, duke përfshirë metodën e monitorimit të vlerës së instrumenteve që Banka Popullore pranon si garanci për kredinë në situata të skajshme?			
24	A ka zhvilluar banka plan për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit në kushte emergjente?			
25	A rishikohet periodikisht plani i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme, në përputhje me ndryshimet në kushtet e brendshme dhe të jashtme të funksionimit të bankës?			
26	A ka miratuar auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme për auditimin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit??			
27	A është frekuenca e auditimeve të brendshme që ka të bëjë me rrezikun e likuiditetit në përputhje me ekspozimin e bankës ndaj këtij rreziku dhe me sistemin e vendosur të administrimit të këtij rreziku?			
28	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm??			
29	Kur prezanton një produkt ose shërbim të ri, a kryen banka një analizë të dokumentuar për të vlerësuar ndikimin e tyre në ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit dhe në procesin e menaxhimit të këtij rreziku?			
30	A ka banka sistem informacioni për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, i cili është i përshtatshëm me shkallën dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të bankës?			

31	A ofron sistemi raportim në kohë dhe të saktë tek organet drejtuese në lidhje me ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të likuiditetit?			
32	A e informoi banka në kohë Bankën Popullore për uljen e shkallës së mbulimit të likuiditetit nën nivelin minimal?			
33	A e bën banka testin e stresit të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit?			
34	A i merr banka parasysh rezultatet e testit të stresit të bërë gjatë përcaktimit të likuiditetit të brendshëm?			
35	A është krijuar një këshill i posaçëm në bankë, i cili është përgjegjës për menaxhimin e mjeteve dhe detyrimeve?			
36	A mund të sigurojë banka informacion për depozituesit dhe depozitat e tyre që janë subjekt i sigurimit në Fondin e Sigurimit të Depozitave?			
37	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi⁵: _____

Nënshkroi _____

⁵ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Rreziku tregtar	PO	JO	Koment
1	A ka banka politika dhe akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut tregtar?			
2	A janë miratuar politika dhe aktet e brendshme për menaxhimin e rrezikut tregtar nga autoriteti përkatës kompetent?			
3	A përmban politika e bankës për administrimin e rrezikut tregtar, rregulla të përgjithshme për strukturën organizative të menaxhimit të rrezikut tregtar; a bazohet në dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut, përkatësisht a është harmonizuar me planin zhvillimor të bankës dhe politikën e biznesit?			
4	A i përfshin politika dhe aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut tregtar, fazat e identifikimit, matjes, kontrollit ose zvogëlimit dhe monitorimit të rrezikut?			
5	A rishikohen rregullisht politika e bankës dhe aktet e tjera të brendshme, për menaxhimin e rrezikut tregtar?			
6	Punonjësit e bankës, të cilët janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut tregtar, a janë të njohur me përmbajtjen e politikës dhe akteve të brendshme për menaxhimin e këtij rreziku dhe a i respektojnë?			
7	A ka ndarje të qartë operacionale dhe organizative brenda strukturës organizative të bankës ndërmjet aktiviteteve tregtare dhe operacioneve të prapavisë që lidhen me tregtimin, duke përfshirë ndarjen e qartë të përgjegjësisë dhe kompetencave të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të cilët janë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve tregtare dhe për operacionet në prapavijë, në lidhje me tregtinë?			
8	A u lejohe qasja vetëm personave të autorizuar në sistemin e tregtimit, të dhënat dhe dokumentet e rëndësishme?			
9	A ka përcaktuar banka brenda akteve të saj të brendshme pragje për treguesit e brendshëm të likuiditetit, pragje për paralajmërimin e hershëm dhe pragje të brendshme për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut tregtar dhe a i zbaton dhe monitoron kufizimet e ekspozimit në lidhje me rrezikun tregtar dhe a ekziston një sistem të përcaktimit të tejkallimeve të kufizimeve?			
10	A ka përcaktuar banka në aktet e saj të përjashtime të lejuara dhe procedurë për miratimin e tyre?			
11	A përdor banka instrumente financiare për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj rrezikut kreditor (derivate)?			
12	A është siguruar monitorimi i përditshëm i rreziqeve që rrjedhin nga aktivitetet e tregtimit dhe të paktën të dhënat për tregjet e kryera, shumën e pragjeve të realizuara dhe			

	kufizime brendshëm dhe tejkalimin e tyre, si dhe për rezultatet e tregtimeve të kryera?			
13	A informohet menjëherë këshilli drejtues i bankës për çdo tejkalim të pragjeve të përcaktuara dhe kufizimeve të brendshme?			
14	Gjatë prezantimit të instrumenteve të reja, a kryen banka një analizë të dokumentuar për të vlerësuar ndikimin e tyre në ekspozimin ndaj rrezikut të tregut dhe në procesin e menaxhimit të këtij rreziku?			
15	A ofron sistemi i informacionit të bankës të dhëna dhe raporte për strukturën valutore të pozicioneve tregtare, transaksionet tregtare të kryera gjatë një periudhe të caktuar, si dhe raporte sipas llojit të transaksioneve, njësive organizative dhe llojit të instrumentit financiar?			
16	A siguron sistemi i informacionit të bankës të dhëna dhe raporte për transaksionet e rëndësishme (të mëdha) në të cilat ka një devijim nga kushtet e tregut, respektimi i pragjeve të përcaktuara dhe kufizimeve të brendshëm dhe për harmonizimin e përjashtimeve me procedurat e bankës?			
17	A siguron sistemi i informacionit të bankës një pasqyrë të rezultateve aktuale dhe të përgjithshme të tregtimit, të paktën në baza mujore dhe vjetore?			
18	A ka auditimi i brendshëm i bankës akte të brendshme auditimi në fushën e menaxhimit të rrezikut tregtar?			
19	A është frekuenca e auditimeve të brendshme që kanë të bëjnë me rrezikun tregtar në përputhje me nivelin e ekspozimit të bankës ndaj këtij rreziku dhe me sistemin e krijuar për menaxhimin e këtij rreziku??			
20	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm?			
21	A bën banka testimin e stresit të portofolit për tregtim dhe të gjitha transaksioneve që përfaqësojnë ekspozimin ndaj rrezikut tregtar dhe a bën banka inspektime dhe testime periodike të sistemeve për matjen e rrezikut tregtar?			
22	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi⁶: _____

Nënshkroi _____

⁶ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Rreziku operacionale	PO	JO	Koment
1	A ka banka politika dhe akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut operacional?			
2	A janë miratuar politika dhe aktet e brendshme për menaxhimin e rrezikut operacional nga autoriteti përkatës kompetent?			
3	A përmban politika e bankës për administrimin e rrezikut operacional, rregulla të përgjithshme për strukturën organizative të menaxhimit të rrezikut operacional; a bazohet në dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut dhe kulturën e vendosur të rrezikut, përkatësisht a është harmonizuar me planin zhvillimor të bankës dhe politikën e biznesit?			
4	A përmban politika dhe aktet e brendshme të bankës për menaxhimin e rrezikut operacionale, fazat e identifikimit, vlerësimit, kontrollit ose zvogëlimit dhe monitorimit të rrezikut?			
5	A përmban politika e menaxhimit të rrezikut operacional një përkufizim të të gjitha llojeve të rreziqeve operacionale ndaj të cilave banka është ose mund të ekspozohet?			
6	A rishikohen rregullisht politika dhe aktet e brendshme të bankës për menaxhimin e rrezikut operacional?			
7	Punonjësit e bankës, të cilët janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut operacional, a janë të njohur me përmbajtjen e politikës dhe akteve të brendshme për menaxhimin e këtij rreziku dhe a i respektojnë			
8	A ka përcaktuar banka brenda akteve të saj të brendshme pragje për treguesit e brendshëm të likuiditetit, pragje për paralajmërimin e hershëm dhe pragje të brendshëm për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut operacional dhe a i zbaton dhe monitoron?			
9	A ka banka në aktet e saj të brendshme të përcaktuara përjashtime të lejuara dhe procedurë për miratimin e tyre?			
10	A ka krijuar banka sistem për përcaktimin, monitorimin dhe regjistrimin e numrit, madhësisë dhe të dhënave të tjera përkatëse të ngjarjeve të rëndësishme të dëmshme dhe/ose humbjeve të rëndësishme nga rreziku operacional?			
11	Gjatë identifikimit të rrezikut operacional, a merr banka parasysh faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që mund të kenë ndikim negativ në profilin e saj të rrezikut?			
12	Çfarë instrumentesh përdor banka në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional (p.sh. raportet e auditimit të brendshëm, bazën e të dhënave, vetëvlerësimin, treguesit e rrezikut etj.)?			
13	A ka banka një bazë të dhënash të humbjeve të brendshme nga ngjarjet e rrezikshme që përfshin të gjitha humbjet e			

	realizuara, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut?			
14	A ka banka sistem informacioni për menaxhimin e rrezikut operacional, i cili ofron të dhëna dhe raporte të paktën për: llojin e humbjes nga rreziku operacional, arsyet kryesore që çuan në humbje, sasinë e humbjes dhe masat e ndërmarra, si dhe raportet për ekspozimin ndaj rrezikut operacional nga linjat individuale të biznesit, pjesët organizative, grupet e transaksioneve, ngjarjet e rrezishme etj.?			
15	A ka miratuar banka akte të brendshme në lidhje me sigurinë fizike, për qëllime të menaxhimit të rrezikut operacional??			
16	A ka banka politikë ose program për të menaxhuar rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?			
17	A është siguruar ndarja e aktiviteteve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga aktivitetet e tjera të bankës që nuk lidhen me veprimtaritë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?			
18	A është vendosur kontrolli i përputhshmërisë së operacioneve me rregulloret në fushën e menaxhimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?			
19	A e përcakton banka në politikën dhe/ose aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut operacionale, metodën e identifikimit, vlerësimit, kontrollit ose reduktimit dhe monitorimit të rrezikut ligjor?			
20	A i ka identifikuar banka burimet e rrezikut ligjor?			
21	A e merr banka parasysh rrezikun e sjelljes së papërshtatshme në kuadër të menaxhimit ligjor të rrezikut? Si e menaxhon banka rrezikun e sjelljes së papërshtatshme??			
22	A ka banka të dhëna për rrezikun ligjor (gjobat, shpenzimet e kompensimit të dëmit, shpenzimet e proceseve gjyqësore të humbura, etj.) si pjesë e bazës së të dhënave të rrezikut operacional?			
23	A ka vendosur banka proces të informimit të rregullt të autoriteteve? Cilat të dhëna u raportohen rregullisht autoriteteve (për shembull: për burimet e rrezikut ligjor, për procedurat gjyqësore, për masat dhe aktivitetet e ndërmarra për të zvogëluar rrezikun ligjor) dhe cilat autoritete raportohen?			
24	Kur prezanton një produkt/aktivitet/sistem të ri, a kryen banka analizë të dokumentuar për të vlerësuar ndikimin e tyre në ekspozimin ndaj rrezikut operacional dhe në procesin e menaxhimit të këtij rreziku?			
25	A përfshin sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional personat e jashtëm nga të cilët banka siguron shërbime?			

26	A ka miratuar auditimi i brendshëm i bankës akte të auditimit të brendshëm në fushën e menaxhimit të rrezikut operacional?			
27	A është frekuenca e auditimeve të brendshme që kanë të bëjnë me rrezikun operacional në përputhje me nivelin e ekspozimit të bankës ndaj këtij rreziku dhe me sistemin e krijuar për administrimin e këtij rreziku??			
28	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm??			
29	A ka ndarje të qartë të përgjegjësiave dhe përcaktimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe/ose punonjës të bankës, të cilët do të jenë përgjegjës për marrjen e masave të duhura në rast të kushteve të jashtëzakonshme ose kushteve serioze të çrregullta të punës, në përputhje me planin e vazhdimësisë së biznesit dhe planin e kushteve të jashtëzakonshme?			
30	A janë përmbajtja e planit të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të kushteve të jashtëzakonshme në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut?			
31	A ka ofruar banka testimin e planit të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të kushteve të jashtëzakonshme dhe me çfarë dinamike?			
32	A janë të njohur punonjësit e bankës me përmbajtjen e planit të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të kushteve të jashtëzakonshme?			
33	A ka siguruar banka rishikim periodik të planit të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të kushteve të jashtëzakonshme?			
34	A përfshin plani i vazhdimësisë së biznesit procedurat për transferimin e proceseve të biznesit në vendndodhjen rezervë?			
35	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi⁷: _____

Nënshkroi _____

⁷ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Rreziku i TI-së	PO	JO	Koment
1	A ka banka politikë dhe akte të brendshme për sigurinë e sistemit të informacionit dhe menaxhimin e rrezikut të TI-së?			
2	A ka miratuar banka strategji të TI-së dhe strategji për menaxhimin e rrezikut nga hapësira digjitale?			
3	A respektohen planet strategjike/operative të TI-së??			
4	A ka strukturë organizative në menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe shpërndarjen e detyrave ndërmjet administratorëve të sistemit?			
5	A është krijuar një sistem njoftimi nga OSIS për autoritetet dhe/ose personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë me informacion për menaxhimin e rrezikut të TI-së?			
6	A ka banka një proces identifikimi të rrezikut të TI-së?			
7	A janë realizuar planet e veprimit që rezultojnë nga analiza e rreziqeve dhe strategjia për mbrojtjen nga sulmet nga hapësira digjitale?			
8	A ka kontrolle/masa administrative, teknike dhe fizike për të reduktuar rreziqet e larta të TI-së të identifikuar nga banka?			
9	A ka krijuar banka një mekanizëm për menaxhimin e incidenteve të sigurisë?			
10	A ka vendosur banka një proces testimi të kontrolleve të sigurisë të zbatuara të përfshira në politikën e sigurisë së sistemit të informacionit?			
11	A ka kryer banka teste të pavarura të rezistencës së sistemeve të saj ndaj sulmeve nga hapësira digjitale??			
12	A është vendosur monitorimi dhe raportimi i rregullt i autoriteteve të bankës për funksionimin e sistemeve të TI-së?			
13	A ka banka një proces menaxhimi të konfigurimit?			
14	A ka banka një strategji rezervë të të dhënave? (backup)?			
15	A përfshihen sistemet kritike në strategjinë e krijimit të kopjes rezervë të të dhënave?			
16	A ka banka një kopje mbrojtëse të të dhënave që ruhen jashtë hapësirës digjitale (offline backup)?			
17	A testohet rregullisht integriteti i kopjeve rezervë të të dhënave, sipas intervalit të përcaktuar të termit?			
18	A është përqindja e përditësimeve të sigurisë së sistemeve të instaluar mbi nivelin e përcaktuar për: – Stacione pune (Windows > 85%; Adobe > 85%) – Serverë (Windows > 75%)			
19	A është vendosur procesi i menaxhimit të projekteve të ndryshimeve në sistemet e informacionit?			

20	A ka banka një proces për të siguruar një gjurmë auditimi nga sistemet e TI-së?			
21	A ka ndonjë komponent të TI-së (stacionet e punës, serverët, pajisjet e rrjetit, bazat e të dhënave) me mbështetje të skaduar nga prodhuesi?			
22	A është Këshilli Drejtues i informuar për komponentët e TI-së me mbështetje të skaduar nga prodhuesi dhe a ka plane veprimi për përmirësimin apo zëvendësimin e tyre?			
23	A ka krijuar banka mekanizma për autentifikimin e përforcuar të përdoruesve fundorë në sistemin bankar elektronik dhe celular?			
24	A ka krijuar banka mekanizma për monitorimin e aktiviteteve të klientit dhe ka marrë transaksione pagesash që synojnë të parandalojnë, zbulojnë dhe kontrollojnë më tej mashtrimet e mundshme në sistemet e kanaleve bashkëkohore?			
25	A ka banka sisteme të integruara që kanë aftësinë të njohin praninë e softuerëve me qëllim të keq në kanal (sesionin) e krijuar nga largësia dhe skenarët e njohur të mashtrimit?			
26	A ka krijuar banka sisteme që ofrojnë mbrojtje kundër kërcënimeve të avancuara nga hapësira digjitale (Advanced Persistent Threat – APT)?			
27	A trajtohen punonjësit në fushën e sigurisë së informacionit të paktën një herë në vit?			
28	A janë vendosur kontrole të përshtatshme të TI-së në menaxhimin e cilësisë së të dhënave, si për shembull: kontrollet e automatizuara hyrëse të burimit, kontrollet e transferimit të të dhënave (të ashtuquajturat ETL), kontrollet në depon e raportimit të të dhënave (të ashtuquajturat DWH)?			
29	A është e mundur të ndryshohen drejtpërdrejt të dhënat në raporte pasi ato të gjenerohen?			
30	Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është po, a janë vendosur kontrole në procesin e ndryshimit të të dhënave në raporte?			
31	Sipas pyetjes së mëparshme, a ka ditar (log) në raportet për ndryshimet e bëra në të dhëna?			
32	A i bën auditimi i brendshëm i bankës kontrollet e përgjithshme të vendosura të TI-së?			
33	A respektohen rekomandimet e auditimit të brendshëm?			
34	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Пополнил⁸: _____

Потпис _____

⁸ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Auditimi i brendshëm	PO	JO	Koment
1	A ka organizuar këshilli mbikëqyrës i bankës një shërbim të auditimit të brendshëm??			
2	A është auditimi i brendshëm një pjesë organizative e pavarur që funksionon veçmas nga pjesët e tjera organizative në bankë?			
3	A e rregullon këshilli mbikëqyrës i bankës strukturën organizative, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet me pjesët e tjera organizative në bankë, si dhe përgjegjësinë dhe kushtet për emërimin e drejtuesit të shërbimit të auditimit të brendshëm?			
4	A ka auditimi i brendshëm politika dhe procedura të miratuara nga këshilli mbikëqyrës i bankës, për kryerjen e auditimit?			
5	Auditimi i brendshëm a kryen auditime të rregullta dhe a janë ato në përputhje me planin vjetor të punës së shërbimit, i cili miratohet nga këshilli mbikëqyrës?			
6	A ka siguruar këshilli drejtues i bankës funksionimin normal të shërbimit të auditimit të brendshëm, përkatësisht a ka siguruar që shërbimi i auditimit të brendshëm të ketë qasje në dokumentacionin dhe punonjësit e bankës, për zbatimin pa probleme të aktiviteteve të saj?			
7	A i bën auditimi i brendshëm i bankës kontrollet e vendosura për saktësinë dhe cilësinë e të dhënave të përfshira në pasqyrat financiare dhe njoftimet e Bankës Popullore?			
8	A përfshin auditimi i brendshëm i bankës: - vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efikasitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm; - vlerësimin e zbatimit të politikave të menaxhimit të rrezikut; - vlerësimin e pozicionimit të sistemit të informacionit; - vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së librave komerciale dhe pasqyrave financiare; - kontrollimin e saktësisë, besueshmërisë dhe afatit kohor të njoftimit, në përputhje me rregulloret; - monitorimi i respektimit të rregulloreve, kodit të etikës, politikave dhe procedurave; - vlerësimin e sistemeve të parandalimit të pastrimit të parave; - vlerësimin e shërbimeve që i siguron banka nga shoqëritë për shërbime bankare ndihmëse?			
9	A është të paktën një person në shërbimin e auditimit të brendshëm auditor i certifikuar?			
10	A kryen personi që bën auditimin e brendshëm edhe detyra të tjera?			
11	A e kontrollon auditimi i brendshëm veprimin sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna?			
12	A mbulon auditimi i brendshëm edhe njësitë e biznesit të bankës (degë, filale etj.)?			

13	A i përfshin auditimi i brendshëm ndërmjetësuesit kreditor të bankave??			
14	Auditimi i brendshëm a auditon shoqëritë për shërbime bankare ndihmëse dhe kontratat e lidhura ndërmjet bankës dhe këtyre shoqërive?			
15	A përgatit auditimi i brendshëm raporte për auditimin e brendshëm, të paktën në shtrirjen dhe dinamikën e parashikuar në Ligjin e Bankave dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji?			
16	A ia dorëzon auditimi i brendshëm raportin gjashtëmuor dhe vjetor për funksionimin e këshillit mbikëqyrës, këshillit drejtues dhe komitetit të auditimit të bankës?			
17	Auditimi i brendshëm a njofton menjëherë këshillin mbikëqyrës dhe këshillin drejtues të bankës, nëse gjatë kontrollit konstaton mospërputhje me standardet e menaxhimit të rrezikut, për shkak të së cilës ekziston mundësia e çrregullimit të likuiditetit ose aftësisë së pagesës të bankës?			
18	A e njofton auditimi i brendshëm menjëherë këshillin mbikëqyrës, nëse gjatë kontrollit konstatohet se këshilli drejtues i bankës nuk respekton rregulloret, aktet e përgjithshme dhe procedurat e brendshme të bankës?			
19	A merr masa këshilli drejtues i bankës për të kapërcyer parregullsitë në sistemet e kontrollit të brendshëm, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm?			
20	A e vlerëson këshilli i auditimit efektivitetin e auditimit të brendshëm?			
21	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor, që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi⁹: _____

Nënshkrimi _____

⁹ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.

	Menaxhimi i korporatave	PO	JO	Koment
1	A ka banka dokument për nivelin e pranueshëm të rrezikut, politikën e biznesit dhe planin e zhvillimit, si dhe planet financiare vjetore?			
2	A janë ngritur organet e bankës në përputhje me rregulloren?			
3	A plotësohen kriteret për personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta?			
4	A e vlerëson këshilli drejtues efikasitetin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë?			
5	A e vlerëson këshilli mbikëqyrës të paktën një herë në vit punën e tij nga pikëpamja e anëtarëve individualë dhe kolektivisht dhe a e informon për këtë kuvendin e bankës? A i mbulon vlerësimi kriteret e përcaktuara në rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e mirë të korporatave?			
6	A kryen këshilli mbikëqyrës vlerësimin e përshtatshmërisë së anëtarit të këshillit drejtues, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e mirë të korporatave?			
7	A e informon këshilli drejtues rregullisht këshillin mbikëqyrës për të gjitha aktivitetet dhe ndryshimet në operacionet që janë të rëndësishme për përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës?			
8	A ka përcaktuar banka kriteret për identifikimin e personave të tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta (me përjashtim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, këshillit të menaxhimit të rrezikut, këshillit të auditimit dhe këshillit drejtues)?			
9	A ka banka politikë kompensimi me rregulla dhe kriteret të qarta dhe transparente për përcaktimin e masës së shpërblimit total? A paguhen kompensimet fikse dhe të ndryshueshme në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e mirë të korporatave?			
10	A ka banka politikë për mënyrën e përzgjedhjes, monitorimit të operacioneve dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, këshillit të menaxhimit të rrezikut, këshillit të auditimit dhe këshillit drejtues që plotëson kriteret e përcaktuara në rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e mirë të korporatave?			
11	A kryen funksioni i kontrollit të harmonizimit të rregulloreve vetëm kontrollin e harmonizimit të veprimeve të bankës me rregulloret?			
12	A paraqet përgjegjësi i kontrollit të harmonizimit me rregulloret raport mujor në këshillin drejtues dhe raport gjashtëmujor në këshillin mbikëqyrës të bankës?			
13	A mundëson struktura organizative e bankës pavarësinë e funksioneve të kontrollit?			
14	A kanë personat që janë përgjegjës për funksionet e kontrollit qasje të pakufizuar tek anëtarët e këshillit mbikëqyrës??			

15	A është informuar këshilli mbikëqyrës i bankës për shkarkimin e përgjegjësit të menaxhimit të rrezikut dhe/ose të përgjegjësit të kontrollit të harmonizimit me rregulloret dhe për arsyet e shkarkimit?			
16	A ka banka politikë për shmangien e konfliktit të interesit?			
17	A ka banka kod të menaxhimit të korporatave?			
18	A publikon banka të dhëna dhe informacione dhe a siguron transparencë në lidhje me menaxhimin e saj të korporatave?			
19	A ka ndonjë aspekt shtesë që auditori beson se duhet të shënohet në këtë pyetësor që nuk mbulohet nga pyetjet e mëparshme?			

Plotësoi¹⁰: _____

Nënshkroi _____

¹⁰ Shënohet personi/personat e shoqërisë së auditimit i cili/të cilët e plotësoi/e plotësuan pyetësin.